KËRKESË
Nr. 672/8, datë 11.7.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për projektin "Rikualifikim urban në lagjen '5 Shtatori', Çorovodë, blloku nr. 1 (faza e parë)".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Skrapar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasurinë, pronë private, sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, për pasuritë e llojit "garazh", bazuar në VKM-në nr. 138, datë 23.3.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit 322,803 (treqind e njëzet e dy mijë e tetëqind e tre) lekë.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Skrapar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Kastriot Gurra

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI "RIKUALIFIKIM URBAN NË LAGJEN '5 SHTATORI', ÇOROVODË, BLLOKU NR. 1 (FAZA E PARË)"

	Pronari				Të dhëna hipotekore								Vlerësimet për shpronësim							
									Truall				Ndërtesë					Vlera totale (lekë)	Shënime
Nr.	Emër	Atësia	Mbiemër	Qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale (m²)	Truall (m²)	Ndërtesë (m²)	Vol.	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lekë)		
A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R	S	W	X
1	Ylli Dhurata	Shuaip Avni	Shahini Shahini	Çorovodë	1420	13/100	Garazh	22.00	-	22	16	151		-	-	22	0	322,803.00	322,803.00	Seksioni E: mungon marrëdhënia me truallin, kjo ndërtesë ndodhet mbi truallin me nr. 13/134, v. 16, f. 152.
Shuma paraprake																			**322,803.00**	